



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. të parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:15 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. të parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:15 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj procedurën për aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.10.2023 në ora 11:15 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se formulari F02 nuk është plotësuar në kuptim të nenit 60 paragrafit 60.1 të RRPP. Kjo pasi që pjesa e parë e formularit me titull "Identifikimi i operatorit ekonomik" nuk është plotësuar fare nga parashtruesi.

Provë: Shih fotografinë e formularit F02 të dorëzuar nga parashtruesi - Pjesa e parë

## KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                 |                   |
|-----------------|-------------------|
| Nr i Prokurimit | 616-23-5765-2-1-1 |
| Nr i brendshëm  |                   |

Sa i përket tenderit për

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

NUI

Adresa

Vendi

Kodi postar

Numri Telefonit

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj

Adresa elektronike

Data e parashtrimit të kërkesës

02.10.2023

Përmes nenit 60 paragrafit 60.3 të RRPP përcaktohet se

*"Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë (ndër të tjera):*

*a) emrin, adresën postare, adresën elektronike dhe informatat e kontaktit të parashtruesit;*

*d) bashkëngjitur një kopje të njoftimit të kontratës në fjalë ose njoftimit të rezultatit të konkursit për projektim, nëse një e tillë është nxjerrë apo publikuar".*

Formulari F02 të cilin e ka dorëzuar parashtruesi nuk është në përputhje as me nënparagrafin a) dhe as me nënparagrafin b) të nenit 60 paragrafit 60.3 të RRPP. Kjo pasi që në formular nuk ka përcaktuar as emrin, as adresën postare, as adresën elektronike dhe as informatat tjera të parashtruesit sikurse kërkohen me nenin 60 paragrafin 60.3 nënparagrafin a) të RRPP. Njëkohësisht nuk ka bashkëngjitur as kopjen e njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku ka qenë e bashkëngjitur edhe letra standarde për parashtruesin si tenderues i pasuksesshëm. Për më tepër parashtruesi në pjesën e tretë të formularit F02 të kërkesës për rishqyrtim ka thënë se nuk është njoftuar fare me shkrim për rezultatet e aktivitetit të prokurimit.

Provë: Shih fotografinë e formularit F02 të dorëzuar nga parashtruesi - Pjesa e tretë

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

Faqe 2 nga 4

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

Natyrisht se autoriteti kontraktues me rastin e publikimit të njoftimit mbi vendimin e ka publikuar në platformën E-Prokurimi edhe letrën standarde mbi tenderuesit e pasuksesshëm duke përfshirë këtu edhe parashtruesin.

Provë: Shih letrën standarde mbi tenderuesit e pasuksesshëm



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

**Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm<sup>8</sup>**

**Titulli: „Sigurimi fizike i objekteve te KPSH”**

Numri i aktivitetit te prokurimit

|                  |                   |
|------------------|-------------------|
| Nr. i prokurimit | 616-23-5765-2-1-1 |
| Nr i brendshëm   | 616 23 126 211    |

| Radhë | Lënda / grupi: Sigurimi fizike i objekteve te KPSH | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
|-------|--|---------------------------------|
| 1.    | Rojet E Nderit SH.P.K., 810519209                  | 36,704.70                       |
| 2.    | Delta Security SH.P.K., 810325614                  | 40,931.00                       |
| 3.    | K.S. Besa Security SH.P.K., 810500406              | 41,338.84                       |
| 4.    | " SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K., 600665709            | 41,725.20                       |
| 5.    | "Internat Security Association"SH.P.K., 601073042  | 42,124.55                       |
| 6.    | Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion, 810680092     | 45,098.52                       |
| 7.    | "SAS" SH.P.K., 600359617                           | 451,878.24                      |
| 8.    | Security Code, 810883240                           | 462,594.72                      |

Te nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj **nuk qe tenderi me çmimin më të ulët** në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë Operatorit Ekonomik: "KING SECURITY"SH.P.K., me çmimin me të ulët përgjegjshëm prej 32,128.60 € për bazë mujore dhe çmimin e përgjithshëm 385,543.20€

Faqe 3 nga 4

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi jo vetëm që nuk ka ofruar të dhënat e plota që kërkohen në formularin F02 mirëpo edhe ato të dhëna që i ka ofruar nuk janë të sakta plotësisht.

Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit c) të RRPP përcaktohet se “Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në nenin 60.1 dhe nenin 60.2 të kësaj rregullore”. Nga sa u tha më sipër kërkesa për rishqyrtim nuk përputhet me nenin 60.1 dhe 60.2 të RRPP. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 09.10.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.